# SHENIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
(të Ushtrimit të mbyllur më dt. 31.12.2021)

## 1. INFORMACIONE TE PERGJITHESHME

**SIRETA 2F shpk** është regjistruar me vendim të gjykatës shkallës parë **nr. 32385**, si person juridik, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse te **Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqërite tregtare",** nga statuti i saj dhe legjislacioni shqiptar në fuqi për tatimet dhe taksat.

Objekti: Ndërtim, Rikonstruksion, Imp Exp etj.
**Çertifikimi tatimor: NIPT K51501008J**

**Kapitali themeltar: 44,316,416 lekë**, i përbërë nga 1 kuote, me vlerë nominale 44,316,416 lekë.

**Kuotat e pronësisë**:

- **Znj. Fatime Pali**, zotërues e **100 %** te kapitalit .

**Administrator: Znj. Fatime Pali** me të drejta dhe detyra të përcaktuara në statutin e shoqërisë.
Forma juridike e shoqërisë: Shoqëri me përgjegjësi te kufizuar.
**Adresa e selisë : Njësia Administrative Paskuqan, Tiranë.**

Numri i punonjësve me datë 31 Dhjetor 2021 ishte 100 punonjës (2020: 126 punonjës)

## 2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL

### Bazat për përgatitjen e pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, duke respektuar kërkesat e parashikuara në Ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" të ndryshuar si dhe parimet bazë e rregullat e parashikuara ne Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara (SKK).
Për zbatimin e politikave kontabël për vlerësimet si dhe për të tjera elemente të nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare (PF) te vitit 2021, jemi referuar tek SKK nr.1- "Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare". Politikat kontabël janë parimet specifike, bazat, konvencionet, rregullat dhe praktikat e zbatuara nga një njësi ekonomike në përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare. Pasi përzgjidhet një politikë kontabël, ajo zbatohet në mënyrë të qëndrueshme vit pas viti. Politika kontabël mund të ndryshojë ne raste specifike, të parashikuara ne SKK.



SIRETA 2F Shpk NIPT: K51501008J
Cel: +355 67 60 47777 / +355 67 60 44555
Tel: +355 4 236 2726 Fax: +355 4 236 2726 E-mail: sireta2fshpk@hotmail.com
Adresa: Kompleksi "SIRETA 2F", Lagje Babrru Fushë, Njesia Administrative Paskuqan, TIRANË - ALBANIA

Lista e llogarive e përdorur për mbajtjen e regjisrimeve kontabël, është ajo e shpallur nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit.

Pasqyra e Pozicionit Financiar, Pasqyra e Performancës, Pasqyra e Fluksit te Mjeteve Monetare dhe Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto, janë paraqitur sipas formatit te parashikuar ne SKK-2 të përmirësuar. Informacioni për gjëndjen më datë 31.12.2021 është plotesisht i krahasueshem për cdo element të PF. Në shënimet shpjeguese janë paraqitur vlerat analitike për cdonjërin prej tyre.
Sipas parimeve të kontabilitetit të pranuara gjerësisht në Shqipëri, deklarimet financiare janë përgatitur mbi bazën e konceptit materialitetit, të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, të parimit te vijimësiseëtj, sipas SKK 1.

**Bazat e përgatitjes**

Disa të dhëna financiare, të paraqitura në pasqyrat financiare, bazohen në vlerësime të bëra nga drejtuesit e njësisë ekonomike, dhe jo në fakte të vëzhguara në mënyrë objektive. Shembuj të zbatimit të vlerësimeve kontabël janë:
(a) vlerësimi i zhvlerësimeve për kërkesat e arkëtueshme dhe inventarëve;
(b) vlerësimi i jetës së dobishme të aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatgjata jomateriale, si dhe përcaktimi i normave përkatëse të amortizimit;
(c) krijimi i provizioneve për mbulimin e kostove që lidhen me procedurat gjyqësore në proces.
Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.
Vlerat në pasqyrat financiare janë shprehur në monedhën kombëtare Lekë.

**Bazat e matjeve**

Në përgatitjen e pasqyrave financiare janë zbatuar parimet kontabël që njihen si më të përshtatshme për të matur dhe paraqitur gjëndjen financiare, rezultatin financiar dhe flukset e parasë mbi gjendjen e kontabilitetit rrjedhës ( të drejtat dhe detyrimet e konstatuara).
Matja fillestare e aktiveve dhe detyrimeve që plotësojnë kriterin e njohjes, bëhet me koston historike, përveç rasteve kur SKK 1, kërkon matje fillestare mbi një bazë tjetër të tillë si vlera e drejtë. Vlerësimi i mëpasshëm i aktiveve dhe detyrimeve financiare bëhet me kosto të amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm, sikurse përcaktohet ne SKK 3, ndërsa te aktivet dhe pasivet e tjera duhet ti referohemi rast pas rasti SKK-ve përkatëse.

**Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat përfaqësojnë flukse hyrëse (rritjen e përfitimeve ekonomike) gjatë periudhës raportuese, që çojnë në rritjen e aktiveve ose pakësimin e pasiveve, si dhe që rrisin kapitalin e njësisë ekonomike raportuese, duke përjashtuar këtu ato që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital. Të ardhurat përfshijnë vetëm hyrjet bruto të përfitimeve ekonomike të marra dhe ato që janë për t'u marrë nga njësia ekonomike për llogari të vet. Shumat e mbledhura për llogari të palëve të treta si taksat e shitjes, taksat e mallrave, produkteve dhe shërbimeve, si dhe tatimi i vlerës së shtuar nuk janë përfitime ekonomike që hyjnë në njësinë ekonomike dhe nuk sjellin rritje të kapitalit neto. Për këtë arsye ato nuk përfshihen në të ardhura.



SIRETA 2F Shpk NIPT: K51501008J
Cel: +355 67 60 47777 / +355 67 60 44555
Tel: +355 4 236 2726 Fax: +355 4 236 2726 E-mail: sireta2fshpk@hotmail.com
Adresa: Kompleksi "SIRETA 2F", Lagje Babrru Fushë, Njesia Administrative Paskuqan, TIRANË - ALBANIA

Të ardhurat përfshijnë vetëm vlerën e drejtë të përfitimeve ekonomike të marra dhe ato që janë për t'u marrë nga shitja e mallrave dhe shërbimeve gjatë aktivitetit te zakonshëm të kompanisë.
Në lidhje me shitjen e mallrave, të ardhurat janë njohur kur ndryshimi i pronësisë së bashku me riskun që vjen nga ky ndryshim, janë transferuar tek bleréesi.

**Njohja e shpenzimeve**

Shpenzimet që lidhen me të ardhurat e fituara gjatë periudhës raportuese njihen në të njëjtën periudhë kontabël si dhe të ardhurat përkatëse. Shpenzimet e kryera gjatë një periudhe raportuese, që ndryshon nga periudha kur ato i sjellin përfitime njësisë ekononike raportuese, rregjistrohen si shpenzime pikërisht në periudhën kur merren përfitimet. Shpenzimet e ndodhura, për të cilat njësia ekonomike nuk pret përfitime të ardhshme, njihen menjëherë nëe rezultatin financiar.

**Aktivet monetare**

Nëe këtë zë përfshihen mjetet monetare gjëndje në datë 31.12.2021 në llogaritë rrjedhëse pranë bankave te nivelit të dytë si dhe në arkë. Për njohjen fillestare të këtyre elementëve si dhe për gjëndjet, është përdorur politika kontabël e vlerës nominale.

**Të drejta të arkëtueshme**

Ne këtë zë janë përfshirë Kërkesa të arkëtueshme nga klientët nga aktiviteti i shfrytëzimit, si dhe kërkesa të tjera debitore, të cilat janë vleresuar me kosto të amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm (nëse ka).

**Detyrime te pagueshme**

Në këtë grup janë përfshirë detyrimet e pagueshme ndaj institucioneve të kredisë, furnitoreve, punonjësve, ortakëve për dividente dhe hua, kreditorëve të tjerë, etj. Në njohjen fillestare zërat e këtij grupi janë vlerësuar me kosto. Në fund të vitit detyrimet vlerësohen me kosto të amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm.
Parimisht, në vijim te njohjes fillestare, huate dhe detyrimet e tjera paraqiten me kosto të amortizueshme duke njohur cdo diference midis kostos dhe vlerës së rikuperueshme në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huamarrjes në bazë të një interesi efektiv.

**Detyrime tatimore**

Në këtë grup përfshihen të gjitha llojet e tatimeve e taksave, të llogaritura e të papaguara ndaj administratës tatimore, të cilat vlerësohen me vlerë nominale. Detyrimet tatimore afatshkurtra dhe afatgjata nuk skontohen dhe nuk zhvleresohen.



SIRETA 2F Shpk NIPT: K51501008J
Cel: +355 67 60 47777 / +355 67 60 44555
Tel: +355 4 236 2726 Fax: +355 4 236 2726 E-mail: sireta2fshpk@hotmail.com
Adresa: Kompleksi "SIRETA 2F", Lagje Babrru Fushë, Njesia Administrative Paskuqan, TIRANË - ALBANIA

**Inventaret**

Në këtë zë janë përfshire gjëndjet e inventarit të "Materialeve të para", që përbëhen nga materiale të ndryshme ndërtimi të nevojshme për shërbimet që ofron shoqëria si dhe lëndë djegëse për makinat e punës.

Inventarët maten fillimisht me kosto. Pas njohjes fillestare të tyre shoqëria vlerëson inventarin me vlerën më të ulët midis kostos dhe cmimit te mundshëm të shitjes minus kostot e transaksionit të shitjes. Cmimi i mundshëm i shitjes i referohet vlerës neto që njësia ekonomike raportuese pret të përfitojë nga shitja e inventarit, në rrjedhën normale të biznesit.
Inventarët i nenshtrohen testit të zhvlerësimit në datën e mbylljes së bilancit. Shuma e Zhvlerësimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ka faktore të objektive që tregojnë që inventarët janë zhvlerësuar.
Metoda e përdorur nga shoqëria për llogaritjen e kostos së stokut është metoda e mesatares së ponderuar.

**Aktive afatgjata materiale (AAM)**

Në bilanc AAM paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlëresimi (nuk ka patur humbje nga zhvlerësimi).
Në këtë grup janë paraqitur gjëndjet e aktiveve afatgjata materiale që përbëhen nga mjete transporti, makineri e vegla pune, pajisje informatike si dhe mobilje e pajisje zyre. Aktivet Afatgjata Materiale janë vlerësuar me koston e blerjes dhe kosto të tjera të drejtpërdrejta që lidhen me sjelljen e aktivit në kushtet e nevojshme për funksionimin e tij.
Metoda për llogaritjen e amortizimit për te gjitha AAM e shoqërisë, është metoda e vlerës së mbetur, e përcaktuar në Ligjin nr. 8438 datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat" të ndryshuar .
Normat vjetore të amortizimit të aplikuara janë si më poshtë vijon:

| Pershkrimi | Norma vjetore | Metoda |
|---|---|---|
| Mjet transporti | 20% | Me vlere e mbetur |
| Makineri e vegla pune | 20% | Me vlere e mbetur |
| Pajisje informatike | 25% | Me vlere e mbetur |
| Mobilje e orendi | 20% | Me vlere e mbetur |

**Shpënzime të shtyra**

Aktivet e njohura si shpenzime të shtyra paraqiten në pasqyrat financiare me Vlerën nominale të shumës së paguar.

**Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara**
Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara përfaqësojnë vlerën e punimeve të kryera deri më datë 31.12.2021.



SIRETA 2F Shpk NIPT: K51501008J
Cel: +355 67 60 47777 / +355 67 60 44555
Tel: +355 4 236 2726 Fax: +355 4 236 2726 E-mail: sireta2fshpk@hotmail.com
Adresa: Kompleksi "SIRETA 2F", Lagje Babrru Fushë, Njesia Administrative Paskuqan, TIRANË - ALBANIA

**Kapitali**

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga kuotat e kapitalit, të cilat janë njohur me vlerën nominale, sikurse përcaktohet në statutin e shoqërisë.

**Të ardhura te tjera dhe shpenzime financiare**

Të ardhurat e tjera përmbledhin të ardhurat nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse, të ardhurat nga interesi, fitimet nga shitja aktiveve financiare të mbajtura për shitje dhe e aktiveve afatgjata materiale, si dhe fitimet nga këmbimet valutore. Të ardhurat nga interesi njihen si detyrime atëhere kur përdoret metoda e interesit efektiv.
Shpenzimet financiare paraqesin shpenzimet per interesat nga huate, humbjet nga kembimet valutore, si dhe humbjet nga zhvleresimet e aktiveve financiare. Gjithe kostot e huamarrjeve njihen ne humbje fitime mbi bazen e perdorimit te metodes se interesit efektiv.

**Tatimi mbi të ardhurat**

Shpenzimi (e ardhura) tatimor është shuma totale që i zbritet (shtohet) fitimit (humbjes) kontabël për përcaktimin e fitimit ose humbjes neto të periudhës kontabël, dhe përbëhet nga shpenzimi (e ardhura) tatimor aktual dhe shpenzimi (e ardhura) tatimor i shtyrë.

Tatimi aktual është shuma e tatimit mbi fitimin, e pagueshme (e zbritshme) mbi fitimin (humbjen) e tatueshëm të periudhës kontabël aktuale. Tatim fitimi është llogaritur në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat" të ndryshuar. Tatim fitimi është llogaritur në masën 15% të të ardhurave të tatueshme.

Tatimi i shtyrë është tatimi i pagueshëm (i zbritshëm) në periudhat e ardhshme, zakonisht si rezultat i realizimit të aktiveve ose shlyerjes së detyrimeve nga njësia ekonomike me vlerën e tyre aktuale kontabël, dhe efekti tatimor i mbartjes së humbjeve tatimore dhe i tatimeve të zbritshme

**Transaksionet në valutë të huaj**

Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën e përdorur duke përdorur kurset e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit.
Fitimet dhe humbjet që rezultojnë nga kryerja e transaksioneve në monedhe të huaj dhe nga konvertimi i aktiveve monetare dhe detyrimeve në monedhë të huaj me kursin e këmbimit të fund-vitit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.
Kurset e këmbimit të përdorura për vlerësimin e gjëndjeve në valutë me datë 31.12.2021 dhe 31.12.2020 janë:

| Monedha | 31 DHJETOR 2021 | 31 DHJETOR 2020 |
|---|---|---|
| EUR | 120.76 | 123.70 |
| USD | 106.54 | 100.84 |



SIRETA 2F Shpk NIPT: K51501008J
Cel: +355 67 60 47777 / +355 67 60 44555
Tel: +355 4 236 2726 Fax: +355 4 236 2726 E-mail: sireta2fshpk@hotmail.com
Adresa: Kompleksi "SIRETA 2F", Lagje Babrru Fushë, Njesia Administrative Paskuqan, TIRANË - ALBANIA

## 2. SHENIME SHPJEGUESE

### 1. Aktivet monetare

| Likujditete dhe vlera arke të tjera | 31.12.2021 | 31.12.2020 |
|---|---|---|
| **Llogari në bankë** | **226,697** | **405,289** |
| Llogari rrjedhëse në LEK | 5,624 | 395,957 |
| Llogari rrjedhëse në EUR | 218,875 | 9,020 |
| Llogari rrjedhëse në USD | 2,198 | 312 |
| **Para në dorë** | **0** | **0** |
| Ne monedhë vëndase | 0 | 0 |
| **Total mjete monetare** | **226,697** | **405,289** |

Vlera e mësipërme përfaqëson totalisht vlerën e likujditeteve në datë 31.12.2021, gjëndje në llogaritë që shoqëria ka pranë bankave të nivelit të dytë në lekë dhe valutë. Gjëndja e likuiditeteve (në bankë) e paraqitur në bilanc rakordon me shumën e ekstraktëve të bankës.

### 2. Të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit

| Emërtimi | 31.12.2021 | 31.12.2020 |
|---|---|---|
| Klientë për shitje materialesh dhe shërbimesh | 208,792,469 | 185,780,966 |
| Shitje materialesh dhe shërbimesh(dhënie tvsh) | 36,583,760 | 18,126,864 |
| Klientë për arkëtime | 624,000 | 624,000 |
| Garanci | | 23,880,527 |
| Provizione për rënie në vlerë të klientëve | -10,639,367 | -11,337,706 |
| Klient pa shpres arkëtimi | -4,363,543 | -2,660,254 |
| **TOTAL** | **230,996,869** | **214,414,396** |

Në postin Klientë për shitje mall e shërbime, janë paraqitur vlerat për tu arkëtuar nga të tretët, për shitje mallrash e shërbimesh. Në postin Shitje materialesh dhe shërbimesh(dhënie tvsh) janë punime të kryera të pa dorezuara por të faturuara për efektin e pageses së tvsh. Evidenca analitike bashkëngjitur e llogarisë kliente është e plotë.

### 3. Të drejta të tjera

| Emërtimi | 31.12.2021 | 31.12.2020 |
|---|---|---|
| Të drejta ndaj doganës | 63,037 | 63,049 |
| Tatim Fitimi | 0 | 0 |
| Debitorë të tjerë | 580,000 | 500,000 |
| **TOTAL** | **643,037** | **563,049** |

### 4. Inventarë

| Emërtimi | 31.12.2021 | 31.12.2020 |
|---|---|---|
| Materiale të para | 0 | 3,333,333 |
| Lëndë djegëse | 0 | 0 |
| Parapagim per material te para | 7,050,000 | 0 |
| Mallra | 0 | 0 |
| Parapagime për inventar | 1,005,400 | 1,005,540 |
| **TOTAL** | **8,055,400** | **4,338,733** |

NDËRTIM - IMP - EXP SIRETA 2F NIPT: K51501008J



SIRETA 2F Shpk NIPT: K51501008J
Cel: +355 67 60 47777 / +355 67 60 44555
Tel: +355 4 236 2726 Fax: +355 4 236 2726 E-mail: sireta2fshpk@hotmail.com
Adresa: Kompleksi "SIRETA 2F", Lagje Babrru Fushë, Njesia Administrative Paskuqan, TIRANË - ALBANIA

4.1 Lëvizja në rubrikën e lëndëve djegëse dhe të materialeve, paraqitet si vijon:

| **Emërtimi** | **31.12.2021** | **31.12.2020** |
|---|---|---|
| Gjëndja në 01.01.2021 | 3,333,333 | 0 |
| Blerje | 156,210,995 | 118,289,402 |
| Dalje | -159,544,328 | -114,956,069 |
| **Gjëndja më 31.12.2021** | **0** | **3,333,333** |

4.2 Mallra

| **Emërtimi** | **31.12.2021** | **31.12.2020** |
|---|---|---|
| Gjëndja në 01.01.2021 | 0 | 0 |
| Blerje mallra | 0 | 87,257 |
| Dalje | 0 | 87,257 |
| **Gjëndja më 31.12.2021** | **0** | **0** |

## 5. Të arkëtueshme aftgjata

| **Emërtimi** | **31.12.2021** | **31.12.2020** |
|---|---|---|
| Garanci per punimet e ndertimit | 18,627,129 | 16,603,847 |
| **TOTAL** | **18,627,129** | **16,603,847** |

## 6.Aktive Afatgjata Materiale

| **Aktive Afatgjata Materiale Kosto** | **Makineri e Pajisje pune** | **Mjete transporti** | **Pajisje zyre etj** | **Pajisje informatike** | **Totali** |
|---|---|---|---|---|---|
| **Gjendje 01.01.2021** | **30,313,827** | **72,723,150** | **1,694,384** | **1,202,505** | **105,933,866** |
| Shtesa | 6,574,773 | 8,689,817 | 25,500 | 291,259 | **15,581,349** |
| Pakesime | (5,558,101) | (20,862,658) | (646,222) | (280,293) | **-27,347,274** |
| **Gjendje 31.12.2021** | **31,330,499** | **60,550,309** | **1,073,662** | **1,213,471** | **94,167,941** |
| | | | | | |
| **Amortizimi** | | | | | |
| **Gjendje 01.01.2021** | **-15,740,253** | **-33,767,732** | **-564,748** | **-434,623** | **-50,507,355** |
| Shtesa | -2,747,269 | -6,250,999 | -159,785 | -109,936 | **-9,267,989** |
| Pakesime | 3,045,173 | 7,542,026 | 330,063 | 188,924 | **11,106,186** |
| **Gjendje 31.12.2021** | **-15,442,349** | **-32,476,706** | **-394,469** | **-355,634** | **-48,669,158** |
| | | | | | |
| Vlera neto 01.01.2021 | **14,573,575** | **38,955,417** | **1,129,636** | **767,882** | **55,426,510** |
| Vlera neto 31.12.2021 | **15,888,150** | **28,073,603** | **679,193** | **857,837** | **45,498,783** |

Aktivet afatgjata materiale janë prone e shoqërisë, janë dokumentuar në mënyre të rregullt dhe priten përfitime nga përdorimi i tyre në të ardhmen.
Vlerat e mesiperme të AAM-ve, përputhet me inventarin fizik të tyre datë 31.12.2021



SIRETA 2F Shpk NIPT: K51501008J
Cel: +355 67 60 47777 / +355 67 60 44555
Tel: +355 4 236 2726 Fax: +355 4 236 2726 E-mail: sireta2fshpk@hotmail.com
Adresa: Kompleksi "SIRETA 2F", Lagje Babrru Fushë, Njesia Administrative Paskuqan, TIRANË - ALBANIA

6.1Detyrime afatshkurtra ndaj institucioneve të kredisë

| Emërtimi | 31.12.2021 | 31.12.2020 |
|---|---|---|
| Hua Bankare Afatshkurtër Raiffeisën Bank(OD) | 49,812,690 | 88,700,000 |
| Qira financiare Afatshkurtër | 2,126,320 | 576,859 |
| Tvsh e qirasë financ. A.shkurtër | -354,387 | -75,071 |
| Detyrim Interesa RZB OD | 0 | 233,944 |
| **TOTAL** | **51,584,624** | **89,435,733** |

6.2.Detyrime afatgjata ndaj institucioneve të kredisë

| Emërtimi | 31.12.2021 | 31.12.2020 |
|---|---|---|
| Qira financiare afatgjatë Raiffeisën Bank | 5,392,013 | 1,563,893 |
| Tvsh e qirasë financ. Afatgjatë | -909,234 | -292,144 |
| **TOTAL** | **4,482,779** | **1,271,750** |

Në këtë rubrikë janë prezantuar detyrimet afatshkurtra dhe afatgjata ndaj Raiffeisën Bank, referuar kontratës për Linjë KredieNr.4758Rep , Nr2622 Kol, dt 25.11.2020 për shumën limit prej 29,000,000 lekë, me afat kthimi 12 muaj , kontratës për Linjë Kredie Nr.47557 Rep, Nr2621 Kol,dt 25.11.2020 për shumën limit prej 31,000,000 lekë, me afat kthimi 12 muaj ,kontratës per Linjë Kredie Nr.4330 Rep , Nr2317 Kol,dt 23.10.2020 për shumën limit prej 30,000,000 lekë, me afat kthimi 12 muaj.
Rinovuar me Kontratat Nr.744Rep , Nr560 Kol, dt 18/02/2022 për shumën limit prej 21,490,000 lekë, me afat kthimi 12 muaj , kontratës për Linjë Kredie Nr.743 Rep , Nr559 Kol,dt 18/02/2022 për shumën limit prej 31,000,000 lekë, me afat kthimi 12 muaj ,kontratës per Linjë Kredie Nr.742 Rep , Nr558 Kol,dt 18/02/2022 për shumën limit prej 15,700,000 lekë, me afat kthimi 12 muaj(Afatet e linjave te kredise jane deri ne 20 Tetor 2022).

Kontratë Qirase financiare prane Raiffaisen Banke nr.269 datë 22.01.2020, me afat 56 muaj,dhe Kontratë Qiras financiare prane Credins Banke nr.3135 datë 19.11.2021, me afat 48 muaj dhe pjesa e pagueshme afatshkurter eshte raportuar ne shenimin nr.6.1 kurse e pagueshme afatgjate eshte raportuar ne shenimin nr.6.2 .

| 7. Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit | 31.12.2021 | 31.12.2020 |
|---|---|---|
| Furnitorë për mallra e shërbime | 60,165,139 | 46,892,845 |
| Furnitorë për mallra, produkte dhe sherbime te konstatuara te pafaturuara lek | 1,500,000 | 0 |
| Kreditore të tjerë | 6,210,000 | 0 |
| **TOTAL** | **67,875,139** | **46,892,845** |

| 8. Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve | 31.12.2021 | 31.12.2020 |
|---|---|---|
| Paga | 3,095,170 | 0 |
| Përfitime Afatshkurtëra ( raport lindje ) | 0 | 0 |
| Sigurime Shoqerore dhe të Ngjashme | 1,124,030 | 960,733 |
| **TOTALI** | **4,219,200** | **960,733** |



SIRETA 2F Shpk NIPT: K51501008J
Cel: +355 67 60 47777 / +355 67 60 44555
Tel: +355 4 236 2726 Fax: +355 4 236 2726 E-mail: sireta2fshpk@hotmail.com
Adresa: Kompleksi "SIRETA 2F", Lagje Babrru Fushë, Njesia Administrative Paskuqan, TIRANË - ALBANIA

Detyrimet tatimore të papaguara më datë 31.12.2021 sipas natyrës së tyre dhe vlerat përkatëse janë paraqitur në tabelën e poshtëshënuar.

| **9. Të pagueshme për detyrimet tatimore** | **31.12.2021** | **31.12.2020** |
|---|---|---|
| Detyrim për Tatim Fitimi | 6,336,772 | 3,662,531 |
| Detyrim për Tatim mbi paga | 666,340 | 98,793 |
| Detyrim për TVSh | 1,144,650 | 2,823,833 |
| Detyrim për tatim në burim | 1,081,500 | 75,000 |
| Detyrime të tjera | 0 | 0 |
| **TOTAL** | **9,229,262** | **6,660,157** |

Në llogaritjen e detyrimeve tatimore shoqëria ka mbajtur parasysh kërkesat e Ligjit "Për Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore", "Për TVSH-ne", për "Tatimin mbi të ardhurat" etj, të zbatueshme për aktivitetin e shoqerisë tonë. Këto detyrime pjese e shenimit nr. 8 dhe 9, janë paguar në Janar – Mars 2022.

**10. Hua të pagueshme ndaj ortakut dhe të tjerëve**

| **Emërtimi** | **31.12.2021** | **31.12.2020** |
|---|---|---|
| Divident për tu paguar | 0 | 10,306,056 |
| Hua nga ortaku | 13,184,131 | 13,060,000 |
| Hua të tjera | 2,600,000 | 14,050,000 |
| **TOTAL** | **15,784,131** | **37,416,056** |

**11. Kapitali**

Në mënyrë të përmbledhur, të dhënat për zotëruesit e kapitalit, numërin e kuotave dhe % e zotërimit, paraqiten në tabelën e mëposhtëme: në momentin e krijimit kapitali ka qënë 100,000 lekë.

| Nr | Zotërues të kapitalit | KAPITALII ORTAKEVE | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 31.12.2021 | | | | Date 31.12.2020 | | | |
| | | Nr. Ikuotave | Vlera nominale | Vlera totale e kapitalit | Ne % | Nr. Ikuotave | Vlera nominale | Vlera totale e kapitalit | Ne % |
| 1 | Fatime Pali | 1 | 44,316,416 | 44,316,416 | 100 | 1 | 44,316,416 | 44,316,416 | 100 |
| | **Totali (1)** | 1 | **44,316,416** | **44,316,416** | **100** | **1** | **44,316,416** | **44,316,416** | **100** |

**12. Rezerva te tjera**

Asambleja e Përgjithëshme e shoqërisë "Sireta 2F" sh.p.k., me vendimin e saj datë 16/07/2021 ka vendosur Fitimin neto te vitit 2020 me vlerë 18,613,753 Lekë, ta mbaj si rezervë. Si rezultat rezerva e shoqerise nga 46,184,382 Leke qe ishte me 31.12.2020 u be 64,798,135 Leke. Burimi i tyre eshte fitimi i shoqerisë.



SIRETA 2F Shpk NIPT: K51501008J
Cel: +355 67 60 47777 / +355 67 60 44555
Tel: +355 4 236 2726 Fax: +355 4 236 2726 E-mail: sireta2fshpk@hotmail.com
Adresa: Kompleksi "SIRETA 2F", Lagje Babrru Fushë, Njesia Administrative Paskuqan, TIRANË - ALBANIA

## 13. Fitimi i vitit

Fitimi i vitit 2021 ka pasur nje rritje te rendesishme, krahasuar me vitin 2020. Kjo rritie ka ardhur si rezultat i rrities se te ardhurave dhe i kostove perkatese, proporcionalisht.

## 14. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

| Emertimi | Viti 2021 | Viti 2020 |
|---|---|---|
| **14.1 Nga Veprimtaria kryesore** | **454,569,688** | **273,469,934** |
| Shitje e punimeve dhe e sherbimeve | 434,345,438 | 256,639,908 |
| Shitje (Bare KafeSireta) | | 242,825 |
| Shitje e punimeve te kryera (Faturim per dhenien e t.v.sh) | 20,224,250 | 16,587,201 |
| **14.2 Te ardhura te tjera** | - | **1,142,951** |
| Te ardhura te tjera | - | 996,336 |
| te ardhura nga shitja e AAM | - | 400,000 |
| Kosto e AAM te shitura | - - | 253,385 |
| **TOTAL** | **454,569,688** | **274,612,885** |

Shoqeria ka raportuar ne kete rubrike, te ardhurat nga punimet e ndertimit te realizuara por njekohesisht edhe te punimeve te perfunduara e te padorezuara, vlere e cila redukton te ardhurat ne vitin 2022, kur punimet do ti faturohen klientit perkates.

## 15. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

| | Viti 2021 | Viti 2020 |
|---|---|---|
| Blerje materiale të para | -123,077,186 | -100,035,607 |
| Blerje mallrash | -36,467,143 | -15,007,091 |
| Blerje/Shpenzime mallrash, shërbimesh | -3,044,204 | -5,611,698 |
| Blerje /Shpenzime të tjera | 0 | 0 |
| **TOTAL** | **-162,588,533** | **-120,654,396** |

## 16. Shpenzime të personelit

| Emërtimi | Viti 2021 | Viti 2020 |
|---|---|---|
| Paga dhe shpërblime | -46,926,676 | -36,651,873 |
| Shpenzime të sigurimeve shoq/shend | -7,371,607 | -5,887,084 |
| **TOTAL** | **-54,298,283** | **-42,538,957** |

## 17. Shpenzime të tjera shfrytëzimi

| Emertimi | Viti 2021 | Viti 2020 |
|---|---|---|
| Shpenzime te projekteve te perfunduara ( Riparim defektesh efekt garanci punimesh) | -<br>680,136 | - |
| | - | - |
| Nenkontraktime per punime ndertimi | 74,031,022 | 29,061,103 |
| | - | - |
| Blerje,energji,avull,uje | 994,386 | 618,098 |



SIRETA 2F Shpk NIPT: K51501008J
Cel: +355 67 60 47777 / +355 67 60 44555
Tel: +355 4 236 2726 Fax: +355 4 236 2726 E-mail: sireta2fshpk@hotmail.com
Adresa: Kompleksi "SIRETA 2F", Lagje Babrru Fushë, Njesia Administrative Paskuqan, TIRANË - ALBANIA

| | | |
|---|---|---|
| Sherbime makinerish(pjese nderrimi) | -2,808,052 | -3,810,260 |
| Sherbime makinerish(Vaj+Filtra) | -1,552,354 | -1,494,086 |
| Shpenzime ( punime te konstatuara te faturuara ne janar 2022) | -1,500,000 | - |
| Kancelari | -56,608 | -104,504 |
| Sherbime makinerish(Kolaodime) | -41,658 | -56,083 |
| Sherbime makinerish(Taksa) | -812,518 | -1,205,747 |
| Sherbime makinerish(Tahograf) | -110,500 | -14,167 |
| Sherbime makinerish(Leje Transporti) | - | -51,000 |
| Faqe webside-internet | -118,573 | -18,000 |
| Certifikatat ISO | -328,450 | -374,650 |
| Certifikatat IQT | -191,380 | -273,500 |
| Shpenzime Noteriale | -5,290,417 | -639,733 |
| Auditim i Pasqyrave Financiare | -270,000 | -300,000 |
| Sherbime Analiza Laboratorike | -415,100 | -253,075 |
| Studime arkeologjike dhe sizmike | -479,793 | -208,333 |
| Sherbime Topografike | - | -550,000 |
| Sherbim ndermjetsimi per punonjes | -86,000 | - |
| Shpenzime projektime | -11,414,000 | - |
| Sherbim per skela me qera | -2,650,736 | - |
| Sherbime (Trajnime) | -7,400 | - |
| Sherbime Vleresim Pasurie+Makineri | | -175,833 |
| Shpenzime te ndryshme OD | -170,000 | - |
| Roje Private | -1,678,065 | - |



SIRETA 2F Shpk NIPT: K51501008J
Cel: +355 67 60 47777 / +355 67 60 44555
Tel: +355 4 236 2726 Fax: +355 4 236 2726 E-mail: sireta2fshpk@hotmail.com
Adresa: Kompleksi "SIRETA 2F", Lagje Babrru Fushë, Njesia Administrative Paskuqan, TIRANË - ALBANIA

| | | |
|---|---|---|
| Qera | 13,141,500 | 6,000,000 |
| Sigurime paurive OV | - | 19,125 |
| Sigurime Kontratash | 2,128,258 | 420,287 |
| Siguracionet e Makinerive (TPL) | 969,165 | 1,181,355 |
| Siguracionet e Makinerive (KASKO) | 372,913 | 498,889 |
| Sherbim + paisje zyre (bateri+fisha etj) | 1,174,703 | 990,278 |
| Transferime, udhëtime, dieta | 35,955,110 | 12,213,301 |
| Shpenzime postare dhe telekomunikimi | 581,040 | 564,222 |
| Shpenzime për shërbimet bankare | 170,016 | 107,289 |
| Taksa dhe tarifa vendore | 645,906 | 1,732,965 |
| Shpenzime të tjera për personelin | 767,000 | - |
| Penalitete, gjoba e demshperblime | 801,326 | 717,059 |
| Shpenzime Ndihme per njerezit ne nevoje | - | 30,000 |
| Shpenzime(uniforma punonjesish,jelek kepuc kokore) | 315,312 | - |
| Komisioion I prokurimeve publike | | 997,760 |
| Vlera kontabel per instalime tekniket,makineri,pajisje | 2,920,454 | 253,385 |
| Humbje nga azhornimi i Arkes/Bankes | | 9,399 |
| Kosto e AAM te shitura | 10,754,843 | - |
| Te ardhura te tjera | 1,484,457 | - |
| te ardhura nga shitja e AAM | 5,000,000 | - |
| **TOTAL** | **169,900,238** | **64,943,489** |

NDËRTIM - IMP - EXP SIRETA 2F NIPT: K51501008J



SIRETA 2F Shpk NIPT: K51501008J
Cel: +355 67 60 47777 / +355 67 60 44555
Tel: +355 4 236 2726 Fax: +355 4 236 2726 E-mail: sireta2fshpk@hotmail.com
Adresa: Kompleksi "SIRETA 2F", Lagje Babrru Fushë, Njesia Administrative Paskuqan, TIRANË - ALBANIA

| 18. Zhvlerësimi i aktiveve financiare | Viti 2021 | Viti 2020 |
|---|---|---|
| Humbje nga zhvleresimi i klienteve pa shprese arketimi | -1,703,289 | -2,660,254 |
| Zhvleresim I klienteve | -1,005,400 | -4,066,448 |
| **TOTAL** | **-2,708,689** | **-6,726,702** |

Ne vitin 2020, zhvleresimi i klienteve eshte paraqitur si pjese e shenimit nr.17, ndersa ne vitin 2021, kjo vlere u riklasifikua ne kete shenim, per te paraqitur me sakte ecurine e zhvleresimit te llogarive te arketueshme.

| 19. Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme | Viti 2021 | Viti 2020 |
|---|---|---|
| Të ardhura nga veprimet në monedhë të huaj | 19,530 | 0 |
| Të ardhura nga interesa | 0 | 0 |
| Fitime nga azhornimi i Arkës/Bankës | -6,814 | 52,224 |
| **TOTAL** | **12,716** | **52,224** |

| 20. Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme | Viti 2021 | Viti 2020 |
|---|---|---|
| Shpenzime për OV Linja 1-llog 20401509 | -1,361,889 | -1,431,097 |
| Shpenzime për OV Linja 2-llog 40401509 | -1,445,758 | -1,735,062 |
| Shpenzime për OV Linja 2-llog 50401509 | -885,162 | -257,151 |
| Interesa Leassing RZB | -174,690 | -102,728 |
| **TOTAL** | **-3,867,499** | **-3,526,038** |

| 21. Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin | Viti 2021 | Viti 2020 |
|---|---|---|
| **Fitimi para tatimit** | **51,951,173** | **23,393,505** |
| **Shpenzime të pazbritshme** | **16,001,787** | **8,471,521** |
| **Fitimi tatimor i ushtrimit/ Humbje** | **67,952,960** | **31,865,028** |
| Humbje të mbartura | 0 | 0 |
| **Fitimi i tatueshem i ushtrimit** | **67,952,960** | **31,865,028** |
| **Tatim fitimi 15%** | **-10,192,944** | **-4,779,754** |

Tatim fitimi i llogaritur për vitin 2021 është 10,192,944 lekë, i cili krahasuar me parapagimet e kryera për vitin 2021 me vlerë 3,856,172 Leke , mbetet për tu paguar Tatim Fitim në vlerën 6,336,772 lekë, paraqitur ne shenimin nr. 9.



SIRETA 2F Shpk NIPT: K51501008J
Cel: +355 67 60 47777 / +355 67 60 44555
Tel: +355 4 236 2726 Fax: +355 4 236 2726 E-mail: sireta2fshpk@hotmail.com
Adresa: Kompleksi "SIRETA 2F", Lagje Babrru Fushë, Njesia Administrative Paskuqan, TIRANË - ALBANIA

**Shenim nr. 22 "Transaksionet me palet e lidhura"**

Një transaksion me palët e lidhura është një transferim i burimeve, shërbimeve apo detyrimeve midis palëve të lidhura. Një palë është e lidhur me një njësi ekonomike nëse kontrollon, kontrollohet nga, ose është nën një kontroll të përbashkët me njësinë ekonomike. Po kështu konsiderohen të tille anëtarët e personelit drejtues të njësisë (duke përfshirë familjarë të afërt të ndonjërit prej individëve të referuar më sipër).
Gjatë vitit ushtrimor 2021 shoqëria ka kryer transaksione me ortakun e vetëm dhe administrator të shoqërisë, për shpërndarje fitimi, huamarrje, pagese e pagave mujore dhe dietave.
Po keshtu edhe me pale të tjera të lidhura, për qira, paga e huamarrje pa interes. Më poshtë paraqiten balancat ndaj palëve të lidhura.

| Emertimi | 31.12. 2021 | 31.12. 2020 |
|---|---|---|
| Aktive | 0 | 0 |
| Detyrime | 13,184,131 | 34,816,056 |
| Te ardhura të vitit deri më: | 0 | 0 |
| Shpenzime për qira te vitit deri më: | (6,000,000) | (6,000,000) |

Shpenzimi i pagave bruto për administratorin për vitin 2021 dhe 2020 eshte 2,400,000 Lekë.

**Shenim nr. 23 "Vijimësia e aktivitetit"**

Drejtimi i shoqerisë ka kryer një vlerësim të aftesisë së shoqerisë për të vazhduar aktivitetin në vijimësi dhe është i bindur që shoqëria ka burime për të vazhduar biznesin dhe aktivitetin në të ardhmen. Gjithashtu drejtimi nuk është në dijeni të ndonjë pasigurie materiale që mund të sjellë dyshime të konsiderueshme mbi mundësinë e shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Prandaj, pasqyrat financiare vazhdojnë të përgatiten në bazë të parimit të vijimësisë.Përgatitja e pasqyrave financiare është bazuar në kërkesat e SKK-ve për pasqyrat individuale të shoqërive. Janë përmbushuar kriteret që shoqëria të vazhdojë në vijimësi aktivitetin e saj.

**Shënim nr.24 "Ngjarjet pas datës së bilancit"**

Deri më datë 31.01.2022, datë në të cilën ka perfunduar mbyllja dhe autorizimi i pasqyrave financiare të vitit 2021, nuk ka patur ngjarje materiale, të cilat të jepnin efektin e tyre në gjëndjen dhe rezultatin e raportuar për periudhat ushtrimore të mëparshme.

**Administrator**
**Fatime Pali**

NDËRTIM - IMP - EXP SIRETA 2F NIPT: K51501008J



SIRETA 2F Shpk: NIPT: K51501008J
Cel: +355 67 60 47777 / +355 67 60 44555
Tel: +355 4 236 2726 Fax: +355 4 23 6 2726 E-mail: sireta2fshpk@hotmail.com
Adresa: Kompleksi "SIRETA 2F", Lagje Babrru Fushë, Njësia Administrative Paskuqan, TIRANË - ALBANIA

**SUBJEKTI : " SIRETA 2F " SHPK**
**NIPT : " K51501008J "**
**Inventari automjeteve ne pronesi te subjektit 31/12/2021**

| NR | LLOJI I AUTOMJETIT |
|---|---|
| 1. | AA 009 EP AUDI |
| 2. | AA 084 RV KAMION IVEKO |
| 3. | AA 245 TN AUTOPOMP BETONI |
| 4. | AA 298 UU KAMIONCINE MITSUBISHI |
| 5. | AA 328VZ AUTOVETUR ME NR SHASIE WNB9026721R245261 |
| 6. | AA 354 UB KOKE TERHQESE VOLVO |
| 7. | AA 391 FB TRAJLERI |
| 8. | AA 397 CL AUTOKULLE IVEKO |
| 9. | AA 548 NX AUTOBITUMATRICE |
| 10. | AA 584XD KOKE TERHEQESE 440/48 VITI 2006 |
| 11. | AA 586 IC KAMION VOLVO |
| 12. | AA 711 HJ KAMION FIAT IVEKO |
| 13. | AA 735 PY KAMION RENAULT ME VINC VITI 1998 |
| 14. | AA 791 GK KAMION IVEKO |
| 15. | AA 798 CP KAMION DAIMLER BENZ |
| 16. | AA 875 VA AUTOBOT UJI IVEKO MAGIRUS 260E VITI 2000 |
| 17. | AA 891 NR KAMION IVEKO |
| 18. | AA MT 14 FADRO JCB |
| 19. | AA029YA KAMION BENZE 1018 |
| 20. | AA099XY AUTOVETURE BMV |
| 21. | AA122XY KAMION ASTRA |
| 22. | AA668RC AUTOVETURE TRANSPORT PUNONJESISH |
| 23. | AA715XY KAMION MERCEDEZ BENC (KARROTREC |
| 24. | AA744XB TOYOTA |
| 25. | AA794CP AUTOBETONIERE FIORI |
| 26. | AA823XN KAMION VOLVO |
| 27. | AB362FK KAMION IVEKO KRAH VINCI |
| 28. | ACR 237 RIMORKIO |
| 29. | AEMT40 FADROM TIM FIAT |
| 30. | AFR 898 RIMORKO |
| 31. | AGMT 61 ESKAVATOR KOMATSU |
| 32. | AGR241_GJYSMERIMORKIO TX34CW_VITI_2006 |
| 33. | AHMT 38 FADROM JCB |
| 34. | APPLE MB AIR13 |
| 35. | ASFALTOSHTRUESE DYNAPAC F141CR S/N 655429 |
| 36. | ASFALTSHTRUESE BITELLI |
| 37. | BETONIERE KANTIERI |
| 38. | DEPOZITE 25.000 LITER |
| 39. | DERE E BLINDUAR |
| 40. | EKRAN KAMER- GRUNDIG LED |



SIRETA 2F Shpk NIPT: K51501008J
Cel: +355 67 60 47777 / +355 67 60 44555
Tel: +355 4 236 2726 Fax: +355 4 236 2726 E-mail: sireta2fshpk@hotmail.com
Adresa: Kompleksi "SIRETA 2F", Lagje Babrru Fushë, Njesia Administrative Paskuqan, TIRANË - ALBANIA

| | |
|---|---|
| 41. | ESKAVATOR ME ZINXHIR CAT322 VITI 2004 |
| 42. | ESKAVATOR ME ZINXHIR LIBER VITI 2007 |
| 43. | ESKAVATOR VOLVO |
| 44. | ESKAVATOR VOLVO MINI |
| 45. | FADROM KOMATSU |
| 46. | GJENERATOR |
| 47. | GJENERATOR |
| 48. | GREIDER NIVELUES MFRISCH F 95 P |
| 49. | KATERPILAR 257B (ME AKSESOR KOV,PIRUN,LLAM,FREZ) |
| 50. | KRIPIERE RRUGE |
| 51. | LAME BOREPASTRUESE |
| 52. | MAKINERI LUCEDIM PLLAKASH |
| 53. | MAKINERI VIJEZIMI |
| 54. | MINI ESKAVATOR VOLVO ECR 88-1CP +2 KOVA |
| 55. | MOTOSALDATRICE GEN - SET |
| 56. | PIRUN NGRITES |
| 57. | RRUL BITELLI |
| 58. | RRUL BITELLI COMPACTU DTV3450 |
| 59. | RRUL BITELLI TIFONE C120, AVENTE TELAO ,SHASIA 01870249 |
| 60. | RRUL BOMAG W213 B2 |
| 61. | RRUL KATERPILAR 2.5 TON |
| 62. | RRUL SHESHUES BOMAG BW144 AD-2 -VIBRATOR |

Per Shoqerine "SIRETA 2F"sh.p.k
Administratore
Fatime PALI

NDËRTIM - IMP - EXP
SIRETA 2F
NIPT: K51501008J



SIRETA 2F Shpk NIPT: K51501008J
Cel: +355 67 60 47777 / +355 67 60 44555
Tel: +355 4 2362726 Fax: +355 4 236 2726 E-mail: sireta2fshpk@hotmail.com
Adresa: Kompleksi "SIRETA 2F", Lagje Babrru Fushë, Njesia Administrative Paskuqan, TIRANË - ALBANIA